

VENDIM
Nr. 14, datë 27.2.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 20.12.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 70/10 Akti që i përket:

KËRKUES: Bajram Farruku

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Polikseni Shehu, Liljana Kajana, Thanas Kajana, Kiti Kajana, Agjencia e Trajtimin të Pronave (ATP), Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Tiranë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 00-2014-2913 (472), datë 18.9.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 2423, datë 20.12.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 4635, datë 7.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, pikat 1 dhe 2, 42, 43, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, Bajram Farruku, që kërkoj pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, ATP-së, që kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Bajram Farruku pretendon se është pronar i një banese me oborr të ndodhur në Tiranë. Këtë pretendim kërkuari e mbështet në vendimin nr. 33, datë 17.1.1961 të Gjykatës Popullore Tiranë me objekt vërtetim gjyqësor fakti (ku trashëgimlënësi i kërkuarit ka ndërtuar një shtëpi të përbërë prej dy odash, kuzhinë e sallon), si dhe në lejen e ndërtimit nr. 82, datë 31.5.1972 në emër të kërkuarit me objekt shtesën e një dhome ngjitur me ekzistuesen.

2. Me vendimin e datës 14.10.1975 të Gjykatës së Rrethit Tiranë është vendosur pjesëtimi i kësaj pasurie ndërmjet kërkuarit dhe vëllait të tij sipas pjesëve takuese, ku kërkuari ka përfituar gjysmën e pasurisë.

3. Me vendimin nr. 463, datë 5.6.1994, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Tiranë ka vendosur të njohë pronar shtetasin Nasi Kajana (trashëgimlënësi i subjekteve të interesuara) mbi një sipërfaqeje toke are të punuar prej 9 dynymësh, si dhe kthimin e një trualli të lirë me sipërfaqe të përgjithshme 4429 m², të përbërë nga tri parcela (parcela 1=2000 m², parcela 2=1700 m², parcela 3=709 m²).

4. Me vendimin nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë është vendosur: “*Plotësimi i vendimit nr. 463, datë 5.6.1994 të KKKP-së Tiranë: të kthejë të drejtën e pronësisë për pronën prej 3405 m² truall të përbërë nga sipërfaqet e lura SL1=2423,5 m²; SL2=67,5 m²; SL3=160 m²; SL4=754m² subjektit të shpronësuar Nasi Kajana (trashëgimtarëve të tij ligjorë), të ndodhur në rrugën “Todi Shkurti”, zona kadastrave 8190 me këto kufij: veriu prona e vetë, jug me xhade, lindja trashëgimtarët e Sadik Memës dhe perëndim Hysen Xhelepi, në bazë të nenit 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”; t’i kompensojë pronën e mbetur prej 1166 m²”.*

5. Kërkuesi duke pretenduar se vendimi nr. 433, datë 9.8.2006 i KKKP-së Tiranë e cenon atë në pronën e tij, e cila ndodhet brenda pronës së kthyer subjekteve të interesuara, i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtij vendimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4635, datë 7.6.2010, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe në prova.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2423, datë 20.12.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4635, datë 7.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2913 (472), datë 18.9.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2423, datë 20.12.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

II

8. **Kërkuesi Bajram Farruku** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

8.1 Vendimi nr. 433, datë 9.8.2006 i KKKP-së Tiranë ka disponuar dy herë në kohë të ndryshme për të njëjtën sipërfaqe trualli, duke kapërcyer kompetencat lëndore të tij, sipas kuptimit të neneve 115/a dhe 116/b të Kodit të Procedurave Administrative.

8.2 Vendimi nr. 433, datë 9.8.2006 i KKKP-së Tiranë është absolutisht i pavlefshëm, sepse vendimi i korrigjuar me këtë vendim është goditur gjyqësisht nga palët në gjykim dhe është konsideruar i drejtë nga gjykata.

8.3 Në gjykimin e një tjetër çështjeje me objekt anulimin e vendimeve nr. 463, datë 5.6.1994 dhe nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë, Gjykata e Lartë ka vendosur dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë për gjysmën tjetër të pronës, e cila i përket vëllait të kërkuesit, në një tjetër proces gjyqësor kanë vendosur në favor të këtij të fundit, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të pjesshme të vendimit nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë.

9. **Subjekti i interesuar, ATP-ja**, pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi nuk përmban asnjë element të cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

9.1 Vëllai i kërkuesit, shtetasi Q.F., ka pretenduar para gjykatës se vendimi nr. 433, datë 9.8.2006 i KKKP-së Tiranë, i dhënë në emër të familjes Kajana, cenon pronën e tij, pasi është nxjerrë në kapërcim të kompetencave të organit administrativ. Ky shtetas e ka bazuar pretendimin e tij në të njëjtat prova, të cilat ishin marrë në shqyrtim nga gjykata në çështjen e kërkuesit, por në këtë rast i është drejtuar gjykatës për pjesën e tij takuese. Këtë pretendim gjykata e rrethit dhe ajo e apelit e kanë gjetur të bazuar, por ndaj këtyre vendimeve ka ushtruar rekurs ATP-ja dhe çështja është aktualisht në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i zbatueshëm në çështjen në shqyrtim.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, ajo nuk bën rivlerësimin e fakteve e të

rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit për sa i takon procesit të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë, kanë të bëjnë në thelb me mënyrën e vlerësimit të provave dhe të zbatimit të interpretimit të ligjit nga këto gjykata. Duke qenë me natyrë ligjore dhe jo kushtetuese, zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Për këto pretendime kërkuarit i është dhënë përgjigje e arsyetuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Kërkuari nuk ka arritur t'i ngrejë pretendimet e tij në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë cenimin e standardeve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, këto pretendime nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjësë së gjykuar

14. Kërkuari pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë për gjysmën tjetër të pronës, e cila i përket vëllait të kërkuarit, në një tjetër proces gjyqësor kanë vendosur në favor të këtij të fundit duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të pjesshme të vendimit nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë. Gjithashtu, në gjykimin e një tjetër çështjeje (me paditës familjen Toptani dhe të paditur subjektet e interesuara) me objekt anulimin e vendimeve nr. 463, datë 5.6.1994 dhe nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë, Gjykata e Lartë ka vendosur dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

15. Bazuar në parimin *jura novit curia* Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuari (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pavarësisht nga fakti se kërkuari nuk ka evidentuar konkretisht standardin e cenuar, Gjykata vlerëson se pretendimet e tij se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për sa u takon vendimeve nr. 463, datë 5.6.1994 dhe nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë (objekt i kërkesëpadisë së kërkuarit) në çështje të ngjashme kanë vendosur në mënyra të ndryshme, duhet të trajtohen në këndvështrim të parimit të gjësë së gjykuar.

16. Gjykata rithekson se dhënia e vendimeve të ndryshme gjyqësore për çështje të njëjta bie ndesh me parimin e sigurisë juridike në praktikën gjyqësore. Parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë siguria juridike nënkupton se nëse gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje (*shih vendimin nr. 21, datë 16.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe zbatimin e së drejtës së përcaktuar në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që ato të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 36, datë 25.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka nënvizuar se *"...në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar është një element themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë, që*

garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vibet më në diskutim” (shih çështjen *Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, datë 12.1.2006). Kjo Gjykatë, në disa çështje kundër Shqipërisë, ka evidentuar rëndësinë e sigurisë juridike në procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave, veçanërisht për sa u përket të drejtave të fituara nga vendimet që kanë njohur të drejta pronësie dhe të ruajtjes së garancive që lidhen me këto të drejta (shih *Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, datë 13.11.2007; *Hamzaraj kundër Shqipërisë*, datë 3.2.2009; *Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, datë 31.7.2012).

19. Gjykata konstaton se në procesin gjyqësor të iniciuar nga vëllai i kërkuarit (shtetasi Q.F.) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8051, datë 30.7.2014, ka vendosur: “*Pranimin e kërkesës së paditësit Q.F. dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të vendimit nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë për sipërfaqen 960 m² që përbën mbivendosje me pronën e paditësit Q.F.*”. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 450, datë 2.3.2016, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 8051, datë 30.7.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me këtë saktësim: “Anulimin pjesërisht të vendimit nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë për sipërfaqen 960 m² që përbën mbivendosje me pronën e paditësit Q.F.”.*”. Në bazë të kërkesës së shtetasit Q.F. është lëshuar edhe urdhri i ekzekutimit të vendimit nr. 8051, datë 30.7.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Pas këtyre veprimeve subjektet e interesuara (pala e paditur në procesin gjyqësor) kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Siç rezulton edhe nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, statusi i kësaj çështje është akoma në proces studimi dhe nuk ka akoma një vendimmarrje të asaj gjykate për këtë çështjeje.

20. Në lidhje me vendimin nr. 00-2014-2089 (417), datë 26.6.2014 të Gjykatës së Lartë, me objekt anulimin e vendimeve nr. 463, datë 5.6.1994 dhe nr. 433, datë 9.8.2006 të KKKP-së Tiranë, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimeve gjyqësore të të dyja shkallëve të gjykimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë me një tjetër trup gjykues. Për më tepër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në këtë vendim është shprehur: “*Nga studimi i akteve të ndodhura në dosje konstatohet se të dy gjykatat e faktit nuk i kanë dhënë një zgjidhje përfundimtare konfliktit midis palëve. Si gjykata e shkallës së parë edhe ajo e apelit duke zbatuar jo drejtë ligjin material kanë arritur në përfundimin e gabuar se padia e paditësve L.T., etj., si padi e kërkit të sendit (neni 296 i Kodit Civil) është e parashkruar në referim të dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë institutin e parashkrimit... Mbështetur në vendimet unifikuere të lartpërmendura, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke i konsideruar gjykimet e këtij lloji si gjykime që në themel të tyre njohin dhe kthejnë pronën e ish-pronarit, trashëgimtarëve të tyre si një e drejtë subjektive, e vlerëson të gabuar përfundimin e arritur nga gjykatat e faktit për rrëzimin e padisë për shkak të parashkrimit referuar nenit 114 të Kodit Civil. Gjykatat e faktit kanë vlerësuar se padia në thelb është një padi e kërkit të sendit. Referuar vlerësimit të mësipërm, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës në Vendimin Unifikues nr. 5, datë 31.5.2011 në të cilin është arritur në përfundimin njëses se: Padia e kërkit të sendit, parashikuar nga neni 296 i Kodit Civil, nga natyra e saj është një padi e paparashkrueshme. Duke qenë se në rastin konkret nuk rezulton që gjykatat të ketë parashtruar argumente ligjore në lidhje me pranimin e padisë; ato nuk kanë arsyetuar rrethanat ligjore që përbëjnë thelbin e kërkit të paditësit dhe prapësimeve të të paditurit; nuk kanë evidentuar faktet apo rrethanat ku konsiston cenimi apo ndërhyrja e palës së paditur në të drejtat e pronësisë së palës paditëse që i kufizojnë atij ushtrimin e tagrave të pronësisë, Kolegji çmon prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë me tjetër trup gjykues.”*

21. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit jo vetëm kanë të bëjnë me çështje gjyqësore të tjera dhe të ndryshme nga çështja e tij, por nuk rezulton që gjykatat të kenë disponuar apo të jenë shprehur në lidhje me pjesën e tij takuese të pasurisë. Gjithashtu, vërehet se këto çështje janë akoma në proces shqyrtimi dhe rishqyrtimi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se këto vendime nuk e vendosin kërkuarin në një situatë të pasigurt nga pikëpamja juridike. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se këto pretendime të kërkuarit janë haptazi të pabazuara.

22. Nisur nga sa më lart, Gjykata, në përfundim të gjykimit, vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuari është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të

Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash¹,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo

¹ Gjyqtari Vladimir Kristo votoi për pranimin pjesërisht të kërkesës vetëm për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë